

**VENDIM**  
**Nr. 261, datë 10.4.2026**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I SHESHIT REKREATIV SHTËRMEN”, BASHKIA CËRRIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i sheshit rekreativ Shtërmën”, Bashkia Cërrik.
  2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Cërrik.
  3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 312 282 (një milion e treqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e dy) lekësh.
  4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 1 312 282 (një milion e treqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e dy) lekësh përballohet nga buxheti i Bashkisë Cërrik.
  5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Cërrik.
  6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
  7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Cërrik.
  8. Bashkia Cërrik kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
  9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Cërrik.
  10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Cërrik për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.
  11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Cërrik për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.
  12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Cërrik, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE E TË CILËVE PREKEN NGA SHPRONËSIMI, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “NDËRTIMI I SHESHIT REKREATIV SHTËRMEN” BASHKIA ÇËRRIK

| Nr.          | PRONARI |       |         | TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË) |                    |                   |                     |                      |             |                |                  |       |      | VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM |     |        |          |          |           |           | SHËNIME<br>(kufizime<br>hipotekare,<br>barrë mbi<br>pasurinë<br>etj.) |
|--------------|---------|-------|---------|---------------------------------------------------|--------------------|-------------------|---------------------|----------------------|-------------|----------------|------------------|-------|------|---------------------------|-----|--------|----------|----------|-----------|-----------|-----------------------------------------------------------------------|
|              |         |       |         |                                                   |                    |                   |                     |                      |             |                |                  |       |      | TRUALL                    |     |        | NDËRTESE |          |           |           |                                                                       |
|              | Emër    | Atësi | Mbiemër | Fshati<br>ose<br>qyteti                           | Zona<br>kadastrale | Nr. i<br>pasurisë | Lloji i<br>pasurisë | Sipërfaqja<br>totale | Arë<br>(m²) | Truall<br>(m²) | Ndërtesë<br>(m²) | Volum | Faqe |                           |     |        |          |          |           |           |                                                                       |
| 1            | Albert  | Lefi  | Braka   | Shtërmen                                          | 3422               | 101/38            | Ndërtesë            | 227.5                | 0           | 0              | 227.5            | 21    | 127  | 0                         | 0   | 0      | 227.50   | 5,425.53 | 1,234,309 | 1,234,309 |                                                                       |
| 2            | Albert  | Lefi  | Braka   | Shtërmen                                          | 3422               | 101/37            | Truall              | 227.5                | 0           | 227.5          |                  | 21    | 126  | 227.5                     | 282 | 64,155 |          |          |           | 64,155    |                                                                       |
| 3            | Arben   | Kovi  | Calja   | Shtërmen                                          | 3422               | 101/39/1          | Truall              | 350                  | 0           | 49             |                  | 22    | 155  | 49                        | 282 | 13,818 |          |          |           | 13,818    |                                                                       |
| Vlera totale |         |       |         |                                                   |                    |                   |                     |                      |             |                |                  |       |      |                           |     |        |          |          |           | 1,312,282 |                                                                       |